

Nocioni dhe llojet e akteve juridike

Aktet juridike

- Siç theksuam më parë normat juridike shpesh herë e përbëjnë ligjin. Ligjet na ana tjetër paraqesin pjesë nga normativa e rregullimit juridik dhe bëjnë pjesë në grupin e akteve juridike. Kjo do të thotë se nëse kemi ligjin për mbrojtjen shëndetësore si akt juridik atëherë normat juridike që janë në përbërje të ligjit do të jenë në kuadër të mbrojtjes shëndetësore. Nga kjo del se akti juridik është mjet për krijimin dhe zbatimin e së drejtës. Pa akt juridik nuk mund të ekzistojë normë juridike, sepse përmbajtjen e normës juridike e përcakton akti juridik.
- Llojet e akteve juridike (shih foto 10)
- Ekzistojnë më tepër kritere për ndarjen e akteve juridike:
 - ə) Sipas asaj si është norma juridike në akt aktet juridike ndahen në:
 - f Aktet e përgjithshme juridike përbëhen nga norma të përgjithshme juridike dhe paraqiten në formë të kushtetutës, ligjeve, akteve të përgjithshme nënligjore. Këto akte juridike si të përgjithshme ju dedikohen të gjithë qytetarëve të një shteti dhe paraqesin bazë për krijimin e akteve individuale juridike. Këto janë burime formale të së drejtës
 - f Aktet individuale (konkrete) përbëhen nga norma individuale juridike. Ata nuk mund të miratohen nëse nuk janë të bazuara në aktin e përgjithshëm juridik të miratuar më parë. Aktet individuale burojnë nga ata të përgjithshmet dhe nuk duhet të jenë në përputhshmëri me ata. Nga kjo del se nuk mund të miratohet akti individual juridik nëse ndonjë sjellje e mëparshme nuk kishte qenë e rregulluar me akt të përgjithshëm juridik ose me normë të përgjithshme juridike. Aktet individuale juridike i zgjedhin situatat konkrete jetësore dhe çdo herë ju dedikohen personave konkret apo një grupi konkret.

- Raporti mes aktit të përgjithshëm juridik dhe atij individual do ta shpjegojmë me shembullin që vijon: Ndalohet vrasja, është normë e përgjithshme juridike, e cila është pjesë përbërëse e kodit penal të Republikës së Maqedonisë si akt i përgjithshëm juridik. Ajo do të thotë se të gjithë qytetarët e RM - së janë të obliguar që ta respektojnë sepse është e përgjithshme dhe se janë të obliguar të gjithë qytetarët. Çdokush që do ta shkel normën juridike do të gjykohet dhe do t'i jepet aktgjykimi si akt individual juridik. Në aktgjykimin do të jenë të përfshira normat individuale juridike me të cilën do të jepet sanksioni konkret për kryerësin konkret të veprës konkrete.
- b) Sipas asaj cili subjekt i sjell aktet juridike ata ndahen në: f Aktet që i miratojnë organet shtetërore, janë në formë të kushtetutës, ligjit aktgjykimit etj. f Aktet që i sjellin organizatat shoqërore siç janë statutet dhe vendimet. f Aktet që i sjellin personat ç zik, të cilat janë në formë të marrëveshjes, testamentit etj.
- c) Sipas llojeve të raporteve shoqërore që i rregullojnë (ekonomike, sociale, kulturore etj.).
- ? PYETJE:
- 1. Çka nënkuptohet me nocionin akt juridik?
- 2. Sipas normave që i përmbajnë, cilat lloje të akteve juridike ekzistojnë?
- 3. Cilat subjekte mund t'i miratojnë aktet juridike?
- 4. Cilat raporte shoqërore i rregullojnë aktet juridike?

Fq. 10. Tregim skematik i akteve juridike

- KUSHTETUTË LIGJ (aktet themelore juridike)
- DISPOZITË, REGULLORE, DEKRET URDHËR, VENDIM, STATUT, UDHËZIM (Akte nënligjore juridike)
- AKTGJYKIM - VENDIM (akte individuale juridike)

10.2. KUSHTETUTA

Ashtu siç mësojmë nga biografi a të dhënat për individin, ashtu edhe nga Kushtetuta e shtetit, mund të shohim se për çfarë shteti bëhet fjalë Për dallim nga ligjet, të cilat janë të shumta në shtet, kushtetuta është akti më i lartë dhe më i rëndësishëm. Kushtetuta është baza në të cilën ndërtohen themelet e shtetit dhe së drejtës. Nga ajo mund të shihet se sa dhe cilat liri dhe të drejta i gëzojnë qytetarët e këtij shteti, si është i organizuar pushteti, cilat organe ekzistojnë, cila është politika e saj si është i organizuar sistemi i mbrojtjes etj. Kushtetuta është “ligj mbi ligjet” sepse në të janë të rregulluara çështjet më të rëndësishme të shtetit si dhe të gjitha aktet juridike dalin nga Kushtetuta dhe duhet të jenë në pajtim me të. Kushtetutën e miraton Kuvendi, ndërsa ndonjëherë në disa vende formohet kuvend i posaçëm që do të miratojë Kushtetutën, dhe më pas ky kuvend shpërbehet. Në themel ekzistojnë shumëllojshmëri kushtetutash. Sipas karakterit kushtetuta mund të jetë e shkruar dhe cila shprehet në dokument të shkruar; kushtetutë jo e shkruar e njohur si kushtetutë zakonore, kushtetutë e fortë dhe e ashpër, e cila rëndë mund të ndryshohet; dhe kushtetutë të butë dhe të lehtë e cila ndryshohet lehtë. Në disa raste kushtetuta paraqitet si dokument i shkruar, por në disa raste përmbajtja e kushtetutës mund të jepet në më shumë deklarata, të cilat për nga vlera që e posedojnë janë të njëjta si kushtetuta. Kemi shembullin e Anglisë, ku në zhvillimin historik të këtij shteti janë paraqitur më shumë deklarata me dispozita kushtetuese. Si për shembull: f Magna Carta Libertatum f Habeas Corpus Act f Bill of Rights Sa i përket strukturës së Kushtetutës, edhe pse nuk është obligative numri më i madh i kushtetutave kanë pjesën hyrëse të quajtur Preambulë. Në preambulë parimisht është i përfshirë qëllimi i kushtetutës. Dhe zhvillimi historik i shtetit. Në themel kushtetuta

Fillet e së drejtës

129

është narrative dhe nuk përmban nene. Nenet janë pjesë përbërëse e pjesës normative pa të cilën kushtetuta nuk mund të ekzistojë. Me qëllim të ndryshimit, plotësimit dhe heqjes së dispozitave kushtetuese dorëzohen amendamente. Ata janë pjesë përbërëse e Kushtetutës. Sa dhe cilat amendamente kushtetuese do t'i ketë një Kushtetutë, varet nga ajo se sa Kushtetuta është e butë apo e fortë. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë përbëhet nga: (shif - foto. 11)

1. Preambula
2. Pjesa normative dhe
3. Amendamentet kushtetuese

- Emri i seksionit Përmbajtja 1. Dispozitat themelore
- 2. Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit
- 3. Organizimi i pushtetit
- 4. Gjykata Kushtetuese e Republikës Së Maqedonisë 5. Pushteti lokal
- 6. Marrëdhëniet ndërkombëtare
- I rregullon karakteristikat baza të një shteti çështjen e shtetësisë simbolet shtetërore (stema, À amuri, himni) kryeqytetin gjuhën zyrtare dhe alfabetin
- Ndarjen themelore të drejtave të njeriut në f qytetarëve, politike f ekonomike sociale dhe kulture I rregullon organet bazë të shtetit: f Kuvendi f Qeveria f Kryetari f Gjykatat f Prokuroria Publike
- E rregullon punën e Gjykatës Kushtetuese I vendos bazat e pushtetit lokal Rregullon udhëheqjen e politikës ndërkombëtare.
- Fillet e së drejtës
- 130
- 7. Mbrojtja e Republikës në kohë lufte dhe në gjendje të jashtëzakonshme 8. Ndryshimi i Kushtetutës
- 9. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare
- E rregullon mbrojtjen e shtetit
- E rregullon procedurën për ndryshimin e Kushtetutës E jep procedurën për përputhjen e sistemit të vjetër me Kushtetutën e re. Foto. 11 Tregim skematik për pjesën normative të Kushtetutës së R. Maqedonisë
- Shembull për amendament Kushtetues AMANDAMENTI IX 1. Republika garanton mbrojtjen, zhvillimin, pasurimin e vlerave artistike dhe historike të Maqedonisë si dhe të gjithë bashkësive etnike në Maqedoni, si dhe si dhe begatitë e tyre pa pasur parasysh regjimin juridik. 2. Me pikën 1 të këtij amendamenti ndryshohet paragrafi 2 i nenit 56 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Pyetje:

- 1. Çka është kushtetuta?
 - 2. Përse është e rëndësishme Kushtetuta për shtetin?
 - 3. Çfarë Kushtetute ekziston?
 - 4. Shpjego strukturën e Kushtetutës së R. Maqedonisë?
-
- Detyrë: 1. Gjej sa amendamente Kushtetuese janë të miratuara në Republikën e Maqedonisë nga viti 1992, deri në vitin 2010.

10.3. LIGJI

- Ligji paraqet akt të përgjithshëm juridik, i cili në hierarkinë e akteve juridike vjen menjëherë pas kushtetutës. Me ligje përpunohen parimet kushtetuese. Ligji duhet të jetë në përputhje me kushtetutën. Nëse është në kundërshtim me të nuk do të vlejë. E miraton organi ligjvënës i shtetit, i cili quhet parlament, kuvend, kongres, дума etj. Ligji mund të shqyrtohet si ligj material dhe formal në kuptimin e plotë të fjalës. Me fjalën ligj në kuptimin material të fjalës, nënkuptohet çdo akt juridik, i cili përmban norma të përgjithshme juridike. Ndërsa me ligjin formal nënkuptojmë çdo akt juridik, të cilin e miraton organi ligjvënës, në procedurë ligjvënëse dhe në formë të shkruar. Ekzistojnë këto lloje të ligjeve: a) Sipas llojit të marrëdhënieve shoqërore që i rregullojnë ka ligje nga lëmi i së drejtës penale, (p.sh. Ligji për procedurë penale, kodi penal), e drejta familjare (ligji për familjen) e drejta trashëgimore, (ligji për trashëgimi) e drejta civile (ligji për të drejtat obligative dhe marrëdhëniet kontraktuese). b) Sipas shumicës së nevojshme për miratim ka ligje që miratohen me: f shumicë relevante f shumicë absolute f shumicë e kualifikuar (ligjet që miratohen me këtë lloj shumice quhen edhe ligje organike, sepse kanë rëndësi esenciale për shtetin. Si p.sh ligji për stemën ligji për A amurin ligji për himnin, ligji për gjykatat, ligji për mbrojtjen etj). c) Sipas kohës të veprimit të ligjeve ata mund të jenë: f të përhershme - veprojnë dhe vlejnë në kohë të pacaktuar, ndërkaq ata në të ardhmen janë ligje në numër të madh që do të miratohen; f ligje latente, janë ato ligje që nuk zbatohen për çdo ditë por vetëm atëherë kur krijohen rrethana të caktuara, gjegjësisht në kushte special. Ligji ekziston dhe është pjesë e së drejtës pozitive, por zbatohet vetëm në situatë të caktuar (p.sh. ligji për mobilizim, i cili zbatohet vetëm në kushte të luftës, ligji për fatkeqësi elementare, i cili zbatohet vetëm në kushte të fatkeqësive elementare).